

**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**

---

**RAPORT  
I INSPEKTIMIT MBI VLERËSIMIN E PERFORMANCËS POLICORE  
NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË GRABITJEVE ME ARMË**

**Nr. 1/2019**

**Prishtinë, 10 maj 2019**

## Informata të përgjithshme

---

<b>Titulli</b>	Raport i inspektimit mbi vlerësimin e performancës policore në trajtimin e rasteve të grabitjeve me armë
<b>Data e përgatitjes</b>	10 maj 2019
<b>Përgatitur nga</b>	Kushtrim Jonuzi, udhëheqës i ekipit të inspektimit, Kadri Keçmezi, inspektor, <b>Mirsad Puçurica, inspektor</b>
<b>Mbikëqyrur nga</b>	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
<b>Mbështetur nga</b>	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
<b>Dorëzuar nga</b>	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
<b>Miratuar nga</b>	Miradije Kelmendi, Kryeshef Ekzekutiv, Inspektorati Policor i Kosovës
<b>Data e miratimit</b>	10 maj 2019



### 1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-5)

### 2. Hyrje

- 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(6-6)  
2.2. Qëllimi i inspektimit.....(6-6)  
2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit.....(6-6)  
2.4. Objektivat e inspektimit.....(6-6)  
2.5. Rëndësia e inspektimit.....(7-7)  
2.6. Metodologjia e inspektimit.....(7-7)  
2.7. Periudha e realizimit dhe mbulimit të inspektimit.....(7-7)  
2.8. Drejtimit e inspektimit.....(7-7)  
2.9. Kriteret e vlerësimit.....(7-8)  
2.10. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(8-8)

### 3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1 Indikatorët e trendit të krimit që lidhen me grabitjet me armë.....(9-12)  
3.2 Veprimet dhe masat policore në hetimin dhe zbulimin e veprave penale të grabitjeve.....(13-23)  
3.3 Kapacitetet e burimeve njerëzore dhe teknike policore.....(24-25)

### 4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1 Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(26-27)

Shtojca

## 1. Përmbledhja ekzekutive

---

### 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Kohëve të fundit në opinion publik është dëgjuar me të madhe për veprat penale të grabitjeve, të cilat kanë shqetësuar qytetarët dhe bizneset në vend. Shqetësimet janë rritur edhe më shumë pas raportimeve se ato në shumë situata janë manifestuar me përdorim të forcës. Janë raportuar humbje financiare në biznese dhe familje, por edhe jetëra të rrezikuara qytetarësh. Krahasuar me vitin 2017, në vitin 2018, trendët pasqyrojnë se shkalla e krimit në vend ka shënuar rënie të lehtë, por ka ngritje simbolike të numrit të grabitjeve. Rreth 2/3 e numrit të përgjithshëm të grabitjeve janë raportuar në kuadër të zonës së përgjegjësisë që kontrollon Drejtoria Rajonale Policore - Prishtinë, duke e bërë më të prekurën nga grabitjet, derisa DRP- Gjakovë ka qenë më pak e ngarkuar me raste të tilla. Rreth 2/3 e numrit të përgjithshëm të rasteve të grabitjeve, të cilat janë raportuar gjatë vitit 2018 kanë qenë grabitje me armë. Rreth 2/3 e numrit të përgjithshëm të grabitjeve me armë kanë përfshirë zonën e përgjegjësisë së DRP-Prishtinë. Ngritje të numrit të grabitjeve me armë kanë shënuar DRP-Gjilan, DRP-Pejë dhe DRP-Prishtinë, kurse DRP-të tjera kanë shënuar rënie të numrit të tyre.

1.1.2. Grabitjet me armë më shumë kanë atakuar filialet bankare - këmbimoret, kazinotë - bastoret sportive, pompat e derivateve, marketet, shtëpitë private, kalimtarët e rastit, etj. Zona e përgjegjësisë së DRP- Prishtinë është më e atakuar nga grabitjet, si zonë me sipërfaqe më të gjërë dhe koncentrim më të madh të njerëzve dhe bizneseve. Referuar në të dhënat statistikore të vitit 2018 mbi grabitjet dhe grabitjet me armë për kokë banori në nivel të zonës së përgjegjësisë së DRP- Prishtinë, afërsisht në 2.600 banorë ka ndodhur një grabitje, apo në 3.800 banorë ka ndodhur një grabitje me armë, kurse në nivel të zonës së përgjegjësisë së DRP-Gjakovë, në 53.000 banorë ka ndodhur një grabitje, apo në 71.000 banorë ka ndodhur një grabitje me armë. Diku rreth 2/5 e numrit të përgjithshëm të grabitjeve me armë kanë prekur zonat rurale, krahasuar me 3/5 që kanë prekur zonat urbane. Afërsisht gjysma e rasteve të grabitjeve janë kryer në intervalet kohore 02.00-04.00 dhe 20.00-22.00, kurse muajt më të ngarkuar me raste të grabitjeve me armë në vitin 2018 në nivel vendi kanë qenë gushti dhe shtatori. Në një numër të konsideruar të grabitjeve me armë, ka pasur rezistencë ndaj urdhrave policore, për të pamundësuar kapjen në flagrancë të kryesve të tyre. Grabitjet janë manifestuar me përdorim të armëve të gjata - të shkurtra, armëve të ftohta dhe pajisjeve tjera në funksion të kryerjes së veprës penale nga kryes individual dhe në grupe të organizuar deri në dhjetë (10) persona.

1.1.3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (DPP) nga viti 2009 ka ende në fuqi Urdhrin Operativ "Unaza e çeliktë", i cili aktivizohet në të gjitha rrethanat kur nuk arrihet që kryesit të kapen në flagrancë ose pas kryerjes së një numri të veprave penale, përfshirë edhe ato të grabitjeve me armë. Për shkak të ngritjes së një numri veprash penale, DPP-ja në vitin 2017 ka nxjerrë Urdhrin Operativ "Rrjeta-2017". Numri i informatave inteligjente mbi grabitjet konsiderohet jo i kënaqshëm për disa DRP dhe konsiderohet si rezultat i një përafrimi jo të duhur me komunitetin, aty ku vlerësohet se mund të merret informacioni. Drejtoria për Inteligjencë e Analizë (DIA) konsiderohet të ketë bërë një punë të kënaqshme në grumbullimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit inteligjent mbi grabitjet. Duke qenë të shqetësuar për numrin e grabitjeve, të cilat për fokus vazhduan të kenë bizneset që kanë qarkullim parash, por duke mos kursyer edhe qytetarët, DPP-ja pas vlerësimit të rrezikut dhe kërcënimit nga grabitjet, në pjesën e dytë të vitit të kaluar ka hartuar Urdhrin Operativ "Rrjeta-2018", përmes të cilit janë obliguar strukturat policore të nxjerrin plane për parandalimin, zbulimin dhe kapjen e kryesve të këtyre veprave. Në aspektin formal, urdhrat - planet plotësojnë

standardet sipas modelit pesë pikësh dhe përmbajnë informata e duhur për trajtimin e grabitjeve. Në zbatimin e Urdhrit Operativ janë përfshirë një numër i madh njësisish policore, të cilat në kuadër të aktivitetit të tyre operacional kanë ndërmarre një varg masash. Ka nevojë të shtimit të aktivitetit parandalues në sektorët patrullues, aty ku duket sikur nuk ka fokus të mjaftueshëm, si rezultat edhe i kapaciteteve të kufizuara të burimeve njerëzore. Me gjithë se planet parashohin shtim të numrit të patrullimeve dhe pikave të kontrollit, disa nga DRP-të kanë reduktuar masat e tilla. Me iniciativë të nivelit qendror, në nivel rajonal janë angazhuar nga dy (2) punonjës me grada, që të monitorojnë implementimin e planeve dhe bashkërendimin e veprimeve policore në parandalim dhe hetim. Është identifikuar një varg aktivitetesh në mes të Policisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe kompanive të sigurimit për koordinimin e aktiviteteve rreth parandalimit të grabitjeve.

1.1.4. Koha e reagimit policor në vendin e ngjarjes apo në ndjekje të grabitësve vlerësohet të jetë brenda standardit, kurse njësitë policore në kuadër të DRP- Mitrovicë Jugu vlerësohet të kenë dalur më së shpejti në vendin e ngjarjes. Në disa logje të ngjarjeve ditore që lidhen me datat e ndodhjes së grabitjeve janë identifikuar informata të mangëta dhe formate të ndryshme të evidencës. Bazuar në informatat e azhuruara nga Sektorët Rajonal të Hetimeve, numri i grabitjeve me armë është më i ulët nga ai që paraqesin raportet inteligjente. Sipas këtyre burimeve zyrtare, rreth 2/5 e numrit të përgjithshëm të rasteve të grabitjeve me armë janë proceduar në Prokurori me kallëzime penale me kryes të njohur, rreth 1/4 me kryes të panjohur, kurse nën hetime vazhdojnë të mbesin rreth 1/3 e rasteve të raportuara gjatë vitit 2018. Me gjithë numrin e madh të rasteve nën hetim, DRP-Prishtinë ka proceduar një numër më të madh të rasteve në Prokurori. Gjysma e DRP-ve kanë realizuar shkallë më të ulët të zbulimit të rasteve dhe procedimit të tyre në Prokurori kompetente.

1.1.5. Në disa dosje të rasteve të grabitjeve që kanë qenë fokus inspektimi, raporti i policit të parë në vendin e ngjarjes përmban informata të pakta dhe nuk përshkruan veprimet primare dhe sekondare të ndërmarra deri në ardhjen e njësisve hetimore dhe të krim - teknikës. Gjatë vlerësimit të veprimeve të njësisve të krim - teknikës në vendngjarje, skicimi i vendngjarjes nuk është zbatuar në disa raste. Janë identifikuar disa raste, ku fotografimi i vendit të ngjarjes nuk është zbatuar. Janë identifikuar situata kur skica e përgjithshme (kroki) dhe skica e detajzuar nuk kanë qenë pjesë e dosjeve. Në të gjitha rastet që janë kontrolluar, Prokuroria ishte njoftuar me kohë për rastet e ndodhura penale. Plani i veprimit sipas të cilit do të zhvillohet procesi hetimor për rastin, nuk është hartuar në një numër të konsideruar të rasteve. Duke parë shqetësimin e qytetarëve dhe të bizneseve, por edhe me qëllim të ngritjes së sigurisë publike, rasteve të grabitjeve iu është dhënë prioritet në trajtimin e tyre.

1.1.6. DRP-të në vazhdimësi ballafaqohen me burime të pamjaftueshme njerëzore, por në zbatim të urdhrave dhe planeve operative, mungesat e tilla janë menaxhuar mirë. Janë evidente vështirësitë lidhur me automjetet zyrtare dhe pajisjet e nevojshme për punë. Luftimi efikas i krimit, përfshirë edhe grabitjet kërkon investim në teknologjinë e monitorimit përmes kamerave në rrugë dhe pjesë të qytetit, si zona të pambuluara e që mund të jenë zona të përshtatshme për kriminelët. Programet trajnuese konsiderohen të përshtatshme për të trajtuar veprat e grabitjeve me armë dhe veprave tjera të ngjajshme. Organizimi i trajnimeve të avancuara do të ishte i mirëseardhur për të ndjekur trendet e luftimit të kësaj dukurie.

## **2. Hyrje**

---

### **2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit**

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK-ja ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Polici, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar një shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Duke u bazuar në legjislacionin aktual, veç inspektimeve që iniciohen bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, IPK-ja zhvillon edhe inspektime të jashtëzakonshme që mund të rrjedhin si kërkesë e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Ministrit të Punëve të Brendshme. Bazuar në këtë, më 31 dhjetor 2018, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka kërkuar inicimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar performancën policore në trajtimin e veprave penale që lidhen me grabitjet e bizneseve dhe familjeve kosovare nga grupet kriminale. Ky inicim ka pasuar pas disa shqetësimeve të Ministrit të Punëve të Brendshme të datës 31 dhjetor 2018, për trendin në ngritje të rasteve të grabitjeve dhe nevojën për të vlerësuar kapacitetet dhe angazhimet policore në trajtimin e kësaj dukurie, drejt dhënies së opinionit mbi efikasitetin e njësisve policore në hetimin dhe zbulimin e krimit. Vlerësimi i kësaj fushe paraqet interes për të hedhur dritë mbi veprimet apo mosveprimet policore, si dhe efikasitetin në trajtimin e rasteve të kësaj natyre kriminale.

### **2.2. Qëllimi i inspektimit**

2.2.1. Qëllimi i inspektimit është:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat policore zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet;
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe nëse janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat;
- Që të jepet mendim objektiv mbi çështjet që lidhen me trajtimin e rasteve kriminale;
- Që të parandalojë në të ardhmen shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës policore në angazhime të kësaj natyre;
- Që të identifikojë mangësitë - dobësitë eventuale dhe të rekomandojë masa adekuate për funksionim më të mirë policor.

### **2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit**

2.3.1. Në këtë inspektim të jashtëzakonshëm është vlerësuar performanca policore në trajtimin e rasteve të grabitjeve me armë. Inspektimi është përqendruar kryesisht në Departamentin e Hetimit, Drejtoritë Rajonale Policore, përfshirë edhe stacionet e prekura nga ky aktivitet kriminal.

### **2.4. Objektivat e inspektimit**

2.4.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Vlerësimi i aktiviteteve në parandalimin e grabitjeve dhe veprave tjera të ngjashme;
- Vlerësimi i aktiviteteve reaktive në hetimin dhe zbulimin e rasteve të grabitjeve;
- Vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave në trajtimin e rasteve;
- Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore - teknike në trajtimin e rasteve të kësaj natyre.

## **2.5. Rëndësia e inspektimit**

2.5.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ngritjen e përgjegjësisë dhe vetëdijes policore në ngritjen e sigurisë publike;
- Identifikimin e veprimeve - mosveprimeve policore gjatë trajtimit të rasteve hetimore;
- Vlerësimin e bashkëpunimit, koordinimit dhe bashkërendimit ndër-institucional;
- Ngritjen e efikasitetit të njësive policore në parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit;
- Identifikimin e nevojave dhe kërkesave që shtyjnë para zhvillimin profesional policor.

## **2.6. Metodologjia e inspektimit**

2.6.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar takime - intervista me drejtues, punonjës, bartës të funksioneve, përfshirë: Drejtorët e Departamenteve të Hetimeve dhe Operacioneve, Drejtorin e DIA-së, Drejtorët Rajonal, Drejtorin e Drejtorisë për Trajnime, dhe hetues të Sektorëve Rajonal të Hetimit;
- b) Janë kryer kontrole - inspektime fizike të: dosjeve të rasteve të grabitjeve (19 sosh);
- c) Janë marrë dokumente, si: planet dhe urdhrat operativ; raportet për vlerësimin e rrezikut nga sektorët e inteligjencës; të dhënat mbi kapacitetet njerëzore dhe teknike në ditët kur kanë ndodhur grabitjet; radiologjet e ditëve kritike kur kanë ndodhur rastet; të dhënat mbi numrin e grabitjeve, zonat dhe kohën e ndodhjes së tyre; të dhënat mbi zbulueshmërinë e rasteve; të dhënat mbi numrin e kallëzimeve të ngritura penale; të dhënat mbi aktivitetet parandaluese dhe operative; të dhëna mbi takimet me komunitetin, forumet e sigurisë dhe bizneset; të dhënat mbi planprogramet trajnuese mbi reagimin policor; raportet e policëve të përfshirë në operacione dhe menaxhimin e rasteve.

## **2.7. Periudha e realizimit dhe mbulimit të inspektimit**

2.7.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datë 14.01.2019 dhe ka përfunduar më 25.01.2019. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e trajtimit të rasteve të grabitjeve të ndodhura përgjatë vitit 2018 dhe fillim vitin 2019.

## **2.8. Drejtimet e inspektimit**

2.8.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Indikatorët e krimit që lidhen me grabitjet me armë;
- Veprimet dhe masat policore në hetimin dhe zbulimin e veprave penale të grabitjeve;
- Kapacitetet e burimeve njerëzore dhe teknike.

## **2.9. Kriteret (standardet) e vlerësimit**

2.9.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave policore:

- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Kosovës;

- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë;
- Rregullorja për Operativë në Policinë e Kosovës (11.04.2017);
- Strategjia për Policimin në Bashkësi;
- Strategjia për Policimin e Udhëhequr nga Inteligjenca;
- Procedura Standarde e Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit (2012-2016) dhe metodologjinë e PK-së për policim në komunitet (DDO-04/044/2013, datë 02.04.2013);
- Procedura Standarde e Operimit - Detyrat e zyrtarit policor në procesin e inteligjencës (ZDPO-02/004/14, datë 24.02.14);
- Procedura Standarde e Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore e hetimit (ZDPO/02/021/2013, datë 16.07.2013);
- Procedura Standarde e Operimit - Veprimet e përgjithshme policore në vendin e ngjarjes (DDO-04/030/2013, datë 28.02.2013);
- Procedura Standarde e Operimit të Teknikës Kriminalistike - Sektori i vendit të ngjarjes (PKSHH - PSO 1.21, datë 12.04.2012).

## **2.10. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave**

2.10.1. IPK-ja vlerëson se gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës inspektuese. Në drejtim të ruajtjes së konfidencialitetit të raporteve inteligjente mbi aktivitetin kriminal dhe statusin e rasteve në procesin e hetimeve, IPK nuk ka në dispozicion dokumentet e tilla dhe ekzistencën (prezencën) e tyre e kanë konfirmuar drejtuesit e strukturës policore të inspektuar.



### **3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet**

---

#### **3.1. Indikatorët e krimit që lidhen me grabitjet me armë**

3.1.1. Në territorin e Republikës së Kosovës, veprat penale të grabitjeve janë të pranishme dhe paraqesin dukuri mjaft shqetësuese për qytetarët në rend të parë dhe institucionet shtetërore, të mandatuara të parandalojnë dhe luftojnë dukuritë negative në shoqëri, që kërcënon sigurinë publike dhe private, që rrezikon jetën e pronën e secilit pa dallim. Kjo dukuri, viteve të fundit ka shqetësuar strukturat relevante për parandalimin e zbulimin e veprave penale, po ashtu edhe opinionin publik, meqë përveç pasurisë së humbur të subjekteve që ishin cak i grabitjeve, kishte edhe humbje të jetës së njerëzve si rezultat i ballafaqimit me kryes të armatosur të këtyre veprave. Rasti i humbjes së jetës së një zyrtari policor në detyrë si rezultat i ballafaqimit me kriminelë gjatë kryerjes së veprave penale të grabitjes në Bankën NLB në Istog, në fund-vitin e kaluar dhe përdorimi i dhunës gjatë grabitjeve në biznese dhe shtëpi të qytetarëve, duke shfrytëzuar armë të zjarrit, armë të ftohta dhe mjete tjera të rrezikshme, kanë kërcënuar seriozisht sigurinë e qytetarëve. Kjo ka shtyrë Policinë që të ndërmarra masat reaguese me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie.

3.1.2. Sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, vepra penale e grabitjes është përkufizuar si formë e rëndë e vjedhjes, ndërsa sanksioni i kësaj vepre është edhe më i rëndë kur kryesi i saj vepron si anëtar i grupit, ose nëse gjatë kryerjes së veprës penale, bartë ose përdorë armë zjarri apo ndonjë mjet tjetër të rrezikshëm<sup>1</sup>. Grabitja me armë është krim i rëndë, veç tjerash mund të traumatizojë viktimat në aspektet fizike - psiqike. Grabitjet me armë kryhen në forma dhe mënyra të ndryshme, përmes kërcënimeve, akteve të dhunës dhe në disa raste mund të përfundojnë edhe me fatalitet. Neni 70 që rregullon veprimet hetimore policore përcakton që pas pranimit të informatës për një vepër penale të dyshuar, Policia heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një vepër penale, që ndiqet sipas detyrës, të jetë kryer. Sipas Kodit, Policia heton veprat penale dhe ndërmerr masat e nevojshme që të zbulojë vendndodhjen e kryesit, të ndalojë kryesin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja, të zbulojë dhe të ruajë gjurmët dhe provat tjera të veprës penale dhe sendet, të cilat mund të shërbejnë si prova, dhe të mbledhë të gjitha informacionet, të cilat mund të përdoren në procedurë penale. Po ashtu, në bazë të Kodit, Policia ka të përcaktuara autorizimet për kryerjen e veprimeve hetimore gjatë fazës fillestare të procedurës penale.

3.1.3. Sipas të dhënave nga raportet vjetore analitike të DRP-ve mbi rastet e raportuara për vitin 2018, me gjithë faktin se veprat penale në nivel të përgjithshëm të DRP-ve kanë shënuar rënie për 1%, grabitjet për dallim nga viti 2017 kanë shënuar ngritje për 2%. DRP- Prishtinë ka evidentuar numrin më të madh të rasteve të grabitjeve (57% përkatësisht 63% e numrit të përgjithshëm të tyre për dy vitet). DRP- Gjakovë ka shënuar numrin më të ulët të këtyre rasteve (5% përkatësisht 1% e

---

<sup>1</sup> Neni 329 i Kodit, lidhur me grabitjen, në paragrafin 1 përcakton se "kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të tillë me qëllim që t'i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet". Paragrafi 3 përcakton se "nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë (7) deri në dymbëdhjetë (12) vjet". Paragrafi 4 përcakton se "kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit të armatosur ose kur vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë (7) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet".

numrit të përgjithshëm të rasteve të grabitjeve për dy vitet). Ngritjen më të theksuar të numrit të rasteve të grabitjeve të shprehur në përqindje e ka shënuar DRP-Pejë me 69% dhe DRP-Prishtinë me 12%. Rënien më të madhe të numrit të rasteve të grabitjeve të shprehur në përqindje e kanë shënuar DRP- Gjakovë me 71% dhe DRP- Mitrovicë Jugu me 35%.

3.1.4. Në bazë të analizave dhe vlerësimeve, 68% e rasteve të grabitjeve të raportuara gjatë vitit 2017 kanë qenë grabitje me armë (198 nga gjithsej 290 sosh), kurse 67% e rasteve të grabitjeve të raportuara gjatë vitit 2018 kanë qenë grabitje me armë (199 nga 297 sosh). Sipas të dhënave të siguruara, gjatë vitit 2018 grabitjet dhe grabitjet me armë kanë shënuar ngritje në nivel vendi për 2% përkatësisht 0.5%. DRP- Prishtinë ka evidentuar numrin më të madh të grabitjeve me armë (59% përkatësisht 63% e numrit të përgjithshëm të grabitjeve me armë në nivel vendi për vitet 2017-2018). Ngritje të numrit të rasteve të grabitjeve me armë ka shënuar DRP- Gjilan dhe DRP-Pejë me nga 50% secila, si dhe DRP- Prishtinë me 8%. Shumica e DRP-ve kanë shënuar rënie të numrit të rasteve të grabitjeve me armë. Rënien më të madhe të numrit të rasteve të grabitjeve me armë, të shprehur në përqindje e kanë shënuar DRP- Mitrovicë Veriu me 83%, DRP- Gjakovë me 40%, DRP- Mitrovicë Jugu me 28%, DRP- Prizren me 27% dhe DRP- Ferizaj me 21%.


DRP	Numri i veprave penale		Trendi (%)	Numri i grabitjeve		Trendi (%)	Numri i grabitjeve me armë		Trendi (%)
	2017	2018		2017	2018		2017	2018	
Prishtinë	13.422	13.566	+1.07	166	186	+12	117	126	+8
Gjakovë	2.205	2.185	-0.9	14	4	-71	5	3	-40
Mitrovicë Veriu	695	594	-14.5	10	10	0	6	1	-83
Mitrovicë Jugu	2.893	2.709	-6.4	26	17	-35	18	13	-28
Prizren	3.708	3.726	+0.49	16	13	-19	11	8	-27
Pejë	3.752	3.941	+5.0	16	27	+69	14	21	+50
Gjilan	3.032	2.805	-7.5	22	20	-9	8	12	+50
Ferizaj	3.471	3.253	-6.3	20	20	0	19	15	-21
<b>Gjithsej</b>	<b>33.178</b>	<b>32.779</b>	<b>-1%</b>	<b>290</b>	<b>297</b>	<b>+2%</b>	<b>198</b>	<b>199</b>	<b>0.5%</b>

3.1.5. Grabitjet me armë janë të pranishme dhe paraqesin dukuri mjaft shqetësuese dhe në bazë të analizave mbi vendndodhjen e tyre, pikat më të atakuara dalin të jenë filialet bankare - këmbimoret, kazinotë - bastoret sportive, pompat e derivateve, marketet, shtëpitë private, kalimtarët e rastit, etj<sup>2</sup>. Zona e përgjegjësisë së DRP- Prishtinë del të jetë më e atakuara nga grabitjet, si zonë me sipërfaqe më të gjërë, ku është koncentruar numër i madh i njerëzve, bizneseve, bankave, institucioneve mikro-financiare, bastoreve- lojërave të fatit, pikave të karburantit dhe marketeve. Sipas Zyres së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, brenda Bashkimit Evropian shkallën më të lartë të grabitjeve në vitin 2016 për 100.000 banorë e ka pasur Franca, kurse më të ultën e ka pasur Sllovakia (153 përkatësisht 10 grabitje për 100.000 banorë<sup>3</sup>). Serbia e Mali i Zi kanë pasur shkallën 27, përkatësisht 20 grabitje për 100.000 banorë, kurse për Kosovën nuk ka pasur matje të tilla. Referuar në të dhënat statistikore policore të vitit 2018 mbi grabitjet dhe grabitjet me armë për kokë banori në nivel vendi,

<sup>2</sup> Drejtoria e Inteligjencës dhe Analizës, *Raporti vjetor analitik në nivel vendi 2017/2018*.

<sup>3</sup> Burimi: The global economy.com (Robbery rate - country rankings - Robberies per 100,000 people, source: The UN office on drugs and crime).

për 100.000 banorë kanë ndodhë 16 grabitje, përkatësisht 11 grabitje me armë<sup>4</sup>. Referuar në të dhënat statistikore mbi grabitjet dhe grabitjet me armë për kokë banori në nivel të zonës së përgjegjësive së DRP - Prishtinë si zonë më e prekur nga këto vepra penale, për 100.000 banorë kanë ndodhur 38 grabitje, përkatësisht 26 grabitje me armë<sup>5</sup>. Referuar në të dhënat statistikore mbi grabitjet - grabitjet me armë për kokë banori në nivel të zonës së përgjegjësive së DRP- Gjakovë, për 100.000 banorë kanë ndodhur 1.9 grabitje, apo 1.4 grabitje me armë<sup>6</sup>. Nga këto të dhëna rezulton se banorët që jetojnë në zonën e përgjegjësive së DRP- Prishtinë kanë gjasë të preken nga grabitjet - grabitjet me armë, më shumë se banorët që jetojnë në zona tjera të vendit tonë. Duke krahasuar shkallën e grabitjeve me trendet ndërkombëtare, shkalla e grabitjeve në nivel vendi nuk konsiderohet e lartë, por më e theksuar është shkalla e grabitjeve për 100.000 banorë për zonën e përgjegjësive së DRP- Prishtinë.




3.1.6. DIA ka kryer një analizë mbi zonat gjeografike ku kanë ndodhur grabitjet më të shumta me armë, sipas të cilës në vitin 2018, 59% e grabitjeve me armë kanë ndodhur në zona urbane, derisa 41% kanë ndodhur në zona rurale. Lidhur me intervalin kohor të ndodhjes së tyre, 28% e grabitjeve me armë kanë ndodhur në intervalin kohor 02.00-04.00, pasuar nga 20% të ndodhura në intervalin kohor 20.00-22.00, 18% në intervalin kohor 00.00-02.00 e kështu me radhë. Numri më i madh i rasteve kanë ndodhur gjatë ditëve, e hënë dhe e dielë, që përbëjnë ditët, gjatë të cilave kanë ndodhë diku gjysma e rasteve, ndërsa, dita e javës gjatë së cilës është evidentuar numër më i ulët i rasteve është dita e mërkurë që pasqyrohet me 4% të totalit të përgjithshëm të rasteve. Sipas të dhënave të siguruar nga Sektorët Rajonal të Hetimeve, të ngarkuar me hetimin e grabitjeve, përfshirë edhe grabitjet me armë, muajt më të ngarkuar me raste të grabitjeve me armë në vitin 2018 në nivel vendi dalin të jenë muaji gusht dhe shtator me nga 14% të të gjitha rasteve të grabitjeve me armë, kurse muajt me numrin më të ulët të grabitjeve me armë janë muaji shkurt, prill dhe maj, të tre

<sup>4</sup> Të dhënat mbi numrin e banorëve janë siguruar nga Vjetari Statistikor 2018 i Entit të Statistikave të Kosovës, sipas të cilit numri i banorëve të vendit është vlerësuar të jetë 1.798.506 banorë.

<sup>5</sup> Të dhënat mbi numrin e banorëve janë siguruar nga Vjetari Statistikor 2018 i Entit të Statistikave të Kosovës, sipas të cilit numri i banorëve të vendit në zonën që mbulon DRP- Prishtinë është vlerësuar të jetë 483.908 banorë.

<sup>6</sup> Të dhënat mbi numrin e banorëve janë siguruar nga Vjetari Statistikor 2018 i Entit të Statistikave të Kosovës, sipas të cilit numri i banorëve të vendit në zonën që mbulon DRP- Gjakovë është vlerësuar të jetë 212.711 banorë.

këta muaj përfaqësohen me nga 6% secila nga totali i përgjithshëm i grabitjeve me armë.



3.1.7. IPK-ja gjeti se në rastet të grabitjeve me armë, ka pasur raste dhe situata kur grabitësit në vendin e ngjarjes nuk iu kanë bindur urdhrave policore, duke tentuar të largohen për t'iu shmangur kapjes dhe arrestimit. Ka pasur raste që kanë rezultuar me përdorim të armës nga ana e grabitësve. Nga gjithsej 199 raste të grabitjeve me armë, në 13 prej tyre apo 7% të numrit të përgjithshëm të tyre janë përcjellur me rezistencë ndaj urdhrave dhe reagimit policor. Zyrtarët policor të DRP- Prishtinë janë ballafaquar në gjashtë (6) raste me grabitësit, të cilët gjatë kryerjes së grabitjes kanë rezistuar ndaj urdhrave policor. Me rezistencë janë ballafaquar edhe zyrtarët policor të DRP- Gjilan, DRP- Prizren dhe DRP-Pejë me nga dy (2) raste dhe DRP- Mitrovicë Veriu me një (1) rast. Në një numër të konsideruar të tyre ka pasur shkëmbim zjarri në mes palëve, duke i karakterizuar këto raste si raste me rrezikshmëri të lartë për jetën e qytetarëve dhe të vetë zyrtarëve policor.

3.1.8. Nga analizimi i rasteve të grabitjeve të evidentuara në zonat e përgjegjësisë së DRP-ve dhe raporteve analitike, në të shumtën e rasteve të grabitjeve me armë, grabitësit kanë pasur për qëllim përfitimin e parave të gatshme për vete dhe grupin. Në vitin 2018 në shumicën e rasteve të grabitjes me armë, grabitësit kanë vepruar si individ dhe në grupe të maskuar dhe mirë të organizuar prej 2 deri në 10 persona. Të dyshuarit kryesisht kanë përdorur armë të gjata, armë të shkurtra, armë të ftohta, po ashtu në disa raste, mjete të forta (shkop bejsbolli metalik, sopatë, shufra, çekan, etj). Pika më të atakuara kanë qenë pikat e karburantit, bankat - institucionet mikro - financiare, kazinot, shtëpi banimi, lojërat e fatit - bastoret sportive, barnatoret, rrugët - hekurudha, parkingjet, dyqanet-supermarketet, argjendaritë, zyret komerciale, hotelet - restorantet, etj. IPK çmon raportet analitike dhe analizat e tilla ndihmojnë në hartimin dhe implementimin e planeve. Sipas informatave të siguruar, grabitjet dhe sidomos ato me armë kryhen nga persona dhe grupe të strukturuar mirë, grupe me të kaluar kriminale jo vetëm në vend, por edhe në shtete të ndryshme evropiane dhe më gjërë. Mosanëtarësimi i vendit në Interpol konsiderohet se është pengesë e madhe në shkëmbimin e informatave për personat e ri-atdhesuar që në shtete të ndryshme kanë të kaluar kriminale.

### 3.2. Veprimet dhe masat policore në parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave penale të grabitjeve me armë dhe kryesve të tyre

3.2.1. Në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, ndër detyrat e përgjithshme të Policisë janë edhe mbrojtja e jetës, pronës dhe ofrimi i sigurisë për të gjithë personat, mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të të gjithë personave, parandalimi i rrezikut ndaj qytetarëve dhe mbajtja e rendit dhe sigurisë publike, parandalimi dhe zbulimi i veprave penale dhe kryesve të tyre dhe hetimi i veprave penale dhe kryesve të tyre. Me qëllim të kryerjes së detyrave dhe përmbushjes së mandatit ligjor policor në parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, Policia e Kosovës ka hartuar Planin Zhvillimor Strategjik (2016-2020), me pesë (5) objektiva strategjike, përfshirë edhe "Ofrimin e sigurisë publike dhe forcimin e bashkëpunimit me qytetarë", si dhe "Parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve të rënda e terrorizmit". Tek objektivi specifik 1.1 (Përmirësimi dhe ruajtja e sigurisë publike, parandalimi dhe zvogëlimi i aktiviteteve kriminale) është paraparë edhe aktiviteti "Zvogëlimi i rasteve kriminale dhe rritja e zbulueshmërisë". Sipas raporteve analitike vjetore të DRP-ve, përgjithësisht vërehet rënie e lehtë e numrit të përgjithshëm të veprave penale për 1%, krahasuar me vitin 2017. Me gjithë se kemi një rënie simbolike të numrit të përgjithshëm të veprave penale, në opinion ka shqetësime evidente mbi grabitjet, përfshirë edhe ato me armë.

3.2.2. DPP-ja që nga viti 2009 ka nxjerrë Urdhrin Operativ "Unaza e çeliktë", i cili aktivizohet në të gjitha rrethanat kur nuk arrihet që kryesit të kapen në flagrancë ose pas kryerjes së një numri të veprave penale, përfshirë edhe ato të grabitjeve me armë. Nga materialet e inspektimit është vërejtur se disa DRP në raste të caktuara kanë aktivizuar Urdhrin për nevoja operative hetimore. Ky Urdhër ka për qëllim të përcaktojë veprimet e shpejta operative dhe taktike reaguese në të gjitha rrethanat kur ndodhin incidente serioze duke aplikuar pika kontrolli, bllokim eventual të rrugëve, vendosjen e kordonëve policor me qëllim të kapjes së kryesve të veprave dhe incidenteve. Inspektimi ka vënë në pah se veç këtij Urdhri, në disa njësi dhe stacione policore janë realizuar plane operative në luftimin e veprave penale, përfshirë edhe grabitjet, por jo në masën çfarë është nevojitur. Në vitin 2017, DPP-ja përmes Departamentit për Operacione ka nxjerrë Urdhrin Operativ "Rrjeta-2017"<sup>7</sup>, si një reagim ndaj rritjes së rasteve kriminale, me theks të veçantë të vjedhjeve, plaçkitjeve, grabitjeve, vjedhjeve të automjeteve, etj. Sipas këtij Urdhri, shkalla e rrezikshmërisë ishte vlerësuar e nivelit e ulët - mesatare. Meqë në pjesën e dytë të vitit 2018, dukuria e shtimit të grabitjeve me armë filloi të bëhet edhe më shqetësuese për bizneset, qytetarët dhe strukturat shtetërore, në Polici ka filluar një mobilizim drejt luftimit të këtyre veprave penale.

3.2.3. IPK është interesuar të njihet me faktin se sa kanë arritur njësitë policore dhe zyrtarët policor të marrin informata inteligjente nga burimet e ndryshme lidhur me grabitjet. Nga inspektimi vërehet se jo të gjitha DRP-të janë të kënaqura me numrin e informatave inteligjente të siguruar nga burimet e tyre në rrugë operative. Nuk është vërejtur se Strategjia e Udhëhequr nga Inteligjenca dhe Strategjia për Policim në Bashkësi të kenë dhënë rezultatet e nevojshme në fushën e bashkëpunimit - përafrimit me qytetarët për ofrimin e informacionit mbi aktivitetin kriminal. Në disa DRP nuk janë identifikuar informata inteligjente nga niveli i stacioneve policore mbi aktivitetin e dyshuar kriminal. Disa njësi të inteligjencës rajonale kanë përpiluar raporte analitike mbi këto aktivitete. Në kuadër të aktivitetit

<sup>7</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Urdhër Operativ "Rrjeta-2017", DDO 04-012-2017, datë 14.02.2017.

operativ për trajtimin e informatave inteligjente që ndërlidhen me grabitje apo vepra të ngjajshme, DIA ka nxjerrë raporte analitike, përmes të cilave ka pasqyruar rastet e raportuara të grabitjeve të armatosura në nivel vendi.

3.2.4. Në drejtim të mobilizimit në luftimin dhe zbulimin e këtyre veprave penale, në tetor të vitit të kaluar, DIA ka nxjerrë Raport analitik në nivel vendi mbi grabitjet me armë<sup>8</sup>, i cili është bërë në harmoni me Procedurën Standarde të Operimit - Procedura e vlerësimit të rrezikshmërisë dhe kërcënimit<sup>9</sup>. Në Raport përshkruhen intervalet gjatë të cilave kanë ndodh grabitjet me armë, zonat-lokacionet e identifikuar, informatat mbi personat e identifikuar, të dyshuar si kryes të mundshëm të disa nga veprat e tilla. Raporti është përpiluar nga të dhënat statistikore, historiku i ngjarjeve të së kaluarës dhe disa pyetjeve vlerësuese. Raporti është bazë me rëndësi për të trajtuar çështjet dhe për të nxjerrë urdhra - plane që shërbejnë dhe ndërlidhin aktivitetet operative-taktike në të gjitha nivelet e organizimit policor për parandalimin, hetimin e zbulimin e grabitjeve me armë. Raporti ka rekomanduar angazhimin e njësisve shtesë afër pikave të nxehta, ngritjen e bashkëpunimit në mes të njësisve, kompanive të sigurimit fizik, agjencive të ndryshme që merren me sigurimin e objekteve dhe qytetarët lidhur me ofrimin e informatave dhe organizimin e operacioneve të fshehta policore në lokacionet afër pikave të nxehta. Edhe në fillim të vitit 2019, DIA ka nxjerrë një Raport analitik në nivel vendi mbi trendin e grabitjeve me armë për periudhën vjetore 2017-2018<sup>10</sup>. Raportet e DIA-së iu janë shpërndarë strukturave rajonale për t'iu shërbyer atyre në planin operativ për luftimin e grabitjeve. Duke çmuar angazhimin dhe kontributin e DIA-së për vlerësimin dhe përpunimin e informacionit të rëndësishëm për grabitjet, inkurajohet që të vazhdojë me aktivitetet të tilla, drejt parandalimit dhe zbulimit të të gjitha veprave penale që kërcënojnë sigurinë e vendit.

#### ***Rekomandimi nr. 1***

*IPK-ja u rekomandon zyrtarëve policor dhe njësisve policore të stacioneve dhe drejtorive rajonale, që në drejtim të sigurimit të informatave rreth kërcënimeve për sigurinë publike, të thellojnë bashkëpunimin dhe partneritetin me qytetarët, bizneset, shoqatat, forumet e sigurisë, në mënyrë që kontributi i tyre të jetë i mundshëm për krijimin e një ambienti të qetë dhe më të sigurt.*

3.2.5. Meqenëse grabitjet me armë kanë paraqitur një dukuri shqetësuese, referuar në raportet inteligjente, konform kompetencave policore dhe mbi bazën e Udhëzuesit për hartimin e urdhrave - planeve operative dhe menaxhimin e operacioneve policore<sup>11</sup>, DPP-ja më 31.08.2018 ka hartuar Urdhër Operativ "Rrjeta-2018". Urdhri është përgatitur sipas modelit pesë pikësh. Paraprakisht ishte kryer vlerësim i përgjithshëm i rrezikut i shkallës mesatar - i lartë, kurse qëllimi i këtij Urdhri është parandalimi dhe luftimi i veprave penale të grabitjeve. Ky Urdhër ka përcaktuar veprimet e nevojshme që duhet ndërmarrë nga struktura policore në të gjitha nivelet dhe ndarjet strukturale të organizimit, varësisht nga detyrat e përgjegjësitë, si dhe bashkëpunimin ndërmjet akterëve brenda e jashtë Policisë. Përmes tij janë obliguar strukturat të nxjerrin plane operative dhe plane veprimi. Për zbatimin e Urdhrit, DRP-të kanë hartuar plane operative me theks të veçantë për grabitjet, të

<sup>8</sup> DIA, Raporti analitik në nivel vendi "Grabitjet me armë janar-gusht 2018/2017", datë 01.10.2018.

<sup>9</sup> Departamenti i Hetimeve, Procedura Standarde e Operimit- Procedura e vlerësimit të rrezikshmërisë dhe kërcënimit, DDH/06/PSO-1.28, datë 31 mars 2017.

<sup>10</sup> DIA, Raporti analitik në nivel vendi "Grabitjet me armë 2018/2017", 21.01.2019

<sup>11</sup> DPP-Departamenti për Operacione, Udhëzues për hartimin e urdhrave dhe planeve operative dhe menaxhimin e operacioneve policore, DDO-04/1-08/010-2014, datë 24.11.2014.

cilat kanë për qëllim parandalimin, zbulimin dhe kapjen e kryesve të tyre. Përveç këtij Urdhri, DPP ka nxjerrë edhe urdhra tjerë që kanë adresuar luftimin e një mori veprash, ku edhe grabitjeve iu është dhënë fokus krahas veprave tjera penale<sup>12</sup>. Nga DRP-të, IPK-ja ka siguruar një numër të konsideruar të planeve, që janë nxjerrë para dhe pas Urdhrit Operativ, që kanë adresuar problemet që lidhen me grabitjet<sup>13</sup>. Përveç nivelit qendror dhe rajonal, në kuadër të secilit stacion policor janë ndërmarrë masa dhe veprime operative për hartimin e planeve operative me qëllim të parandalimit, zbulimit dhe kapjes së kryesve të veprave penale. Në kuadër të stacioneve është hartuar numër i konsideruar i planeve me qëllim të parandalimit e zbulimit të veprave penale brenda zonave të përgjegjësisë së tyre. Është për t'u çmuar angazhimi e kontributi i stacioneve rreth mobilizimit dhe përgaditjes operacionale, veprime këto të cilat kanë efekt në shtimin e vigjilencës policore për parandalimin e dukurive negative dhe ballafaqimin reaktiv më efikas në luftimin dhe zbulimin e kryesve të veprave penale.

3.2.6. Pas kontrollimit të urdhrave - planeve, vërehet se ato janë në harmoni me Udhëzuesin. Si *informatë* tek këto plane operative janë përshkruar dukuritë, që përbëjnë shqetësimet e ngritura për rendin dhe sigurinë e kërcënuar nga dukuritë kriminale evidente gjatë vitit të fundit. Këtu janë përshkruar detaje mbi llojin e veprave penale që po shfaqen, mënyrën e kryerjes së tyre, vendet-lokacionet ku po ndodhin ato dhe koha e shfaqjes së tyre. Tek të gjitha planet e kontrolluara, vlerësimi i rrezikut nga grabitjet me armë është vlerësuar i shkallës mesatar - i lartë. Të dhënat në kuadër të planeve obligojnë Policinë që të jetë maksimalisht e përgaditur e vigjilente për veprime të nevojshme operative. *Qëllim* i këtyre planeve përshkruhet rezultati operacional që synohet të arrihet përmes aktiviteteve operative. Qëllimi i tyre kryesisht është shtimi i masave të sigurisë për garantim të rendit, qetësisë e sigurisë publike brenda zonave të përgjegjësisë, krijimi i ambientit të sigurtë për të gjithë, parandalimi i veprave të kundërligjshme, kapja e kryesve të veprave penale dhe luftimi i të gjitha dukurive negative që mund të shkaktojnë destabilitet e kërcënim për sigurinë publike. *Te metoda* e planeve janë përcaktuar veprime operative e taktike të njësisë si akterë për implementimin e tyre. Te metodologjia e veprimit janë ndarë detyrat për secilën njësi, stacion apo nënstacion të përfshirë në operacion. Në kuadër të kësaj parashihen edhe burimet njëjësore e teknike, të cilat duhet të jenë në dispozicion. *Administrimi* i planeve ka përcaktuar strukturën komanduese si autoritet komandues për realizimin e tyre dhe është përcaktuar vija e komandimit e të gjithë akterëve nga poshtë - lartë strukturës komanduese. Te *komunikimi* në kuadër të secilit plan është përcaktuar vija e komunikimit dhe qendrat e komunikimit që kanë për obligim pranimin e informatave relevante nga vendet e ngjarjes dhe përcjelljen sipas hierarkisë. Në aspektin formal, faza përgaditore e Policisë për t'u ballafaquar me dukurinë e veprave penale të grabitjeve si në aspektin parandalues edhe në atë reagues, vlerësohet të jetë përmbushur në raport me kërkesat, ngase planet i janë përmbajtur standardit të kërkuar me Udhëzues. IPK-ja çmon angazhimet në hartimin e planeve sipas rregullave dhe standardeve, si dhe inkurajon të vazhdohet me angazhimin dhe përkushtimin e tillë.

<sup>12</sup> Urdhri Operativ “Fund viti 2018 dhe fillimi i vitit 2019” (26.12.2018), “Sezoni dimëror 2017/2018” (15.11.2017), “Sezoni dimëror 2018/2019” (29.10.2018), “Sezoni veror 2018” (31.05.2018).

<sup>13</sup> DRP-Prishtinë (“Harku”, “Parandalimi i veprave penale”, “Rrjeta”, “Shtimi i masave të sigurisë”, “Rrufeja” dhe “Perimetri”), DRP-Pejë (“Rrjeta-2018”), DRP-Mitrovicë Jugu (“Parandalimi i veprave penale kundër pasurisë” dhe “Parandalimi i grabitjeve të armatosura”), DRP-Mitrovicë Veriu (“Rrjeta 2018”), DRP-Gjilan (“Rrjeta 2018” dhe “Stop grabitjeve me armë”), DRP-Prizren (“Sezona dimërore 2018”, “Sezona verore 2018”, “Rrjeta 2018”, “Grabitje dhe grabitje me armë” dhe “Parandalimi”), DRP-Ferizaj (“Shtimi i masave të sigurisë” dhe “Unaza e çeliktë”), DRP-Gjakovë (“Urdhëresa për ngritjen e masave të sigurisë”).

3.2.7. Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të grabitjeve, veprave tjera penale dhe kapjes së kryesve të tyre, përveç Urdhrit Operativ "Rrjeta-2018", Departamenti për Operacione ka kërkuar nga DRP-të edhe ndërmarrjen e masave konkrete në zonat e tyre të përgjegjësisë duke angazhuar njësitë e inteligjencës rajonale, ekipet e hetimeve të grabitjeve dhe autokrimet në kuadër të Njësive të Hetimeve të Përgjithshme, Njësitë e Reagimit të Shpejtë (NJRSH), si dhe po që se sigurohen informata konkrete për të dyshuarit të këtyre veprave, që të kërkohet asistencë nga Njësitë Speciale Operative (NJSO) dhe Njësia Speciale Intervenuese (NJSI). DRP-të bazuar në planet operative kanë zhvilluar aktivitete të shumta për parandalimin e veprave penale që kërcënojnë rendin dhe sigurinë publike. Në kuadër të aktiviteteve të përcaktuar me plane dhe aktiviteteve tjera ditore që i zhvillojnë njësitë e stacioneve policore dhe nënstacioneve në kuadër të zonave të përgjegjësisë kanë realizuar pika kontrolli, patrullime me vetura dhe në këmbë. Pikat e kontrollit janë realizuar nga ekipet e stacioneve në bashkëveprim edhe me NJRSH-të. Gjatë muajve kritik janë shtuar pikat e kontrollit duke iu bashkëngjitur edhe NJSO-të. Pikat e kontrollit janë realizuar në afërsi të zonave ku kanë qenë më të atakuara. Përveç pikave të kontrollit, janë realizuar edhe patrullime këmbë nga njësitë e stacioneve në kuadër të zonave të përgjegjësisë. Në implementim të planeve operative, njësitë e rendit kanë vepruar në rroba civile në bashkëveprim me ato të hetimeve rajonale. Bazuar në raportet policore mbi kapacitetet e angazhuara në implementimin e Urdhrit, në muajt nëntor, dhjetor të vitit të kaluar dhe janar të këtij viti vërehet shtim kapacitetesh me personel të uniformuar dhe reduktim i personelit me rroba civile. IPK është interesuar të njihet me nivelin e angazhimeve në kuadër të implementimit të Urdhrit dhe ka vërejtur se patrullimet në këmbë, me automjete dhe pikat e kontrollit kanë një trend në ngritje gjatë muajve të fundit të vitit 2018 dhe fillim vitit 2019.

<b>Tabela nr. 2 - Të dhëna statistikore përmblendhëse mbi aktivitetet pro-aktive dhe reaktive policore në nivel vendi gjatë realizimit të Urdhrit Operativ "Rrjeta - 2018"</b>							
<b>Masat-muaji</b>	<b>Patrullim në këmbë</b>	<b>Patrullim me veturë</b>	<b>Pika kontrolli</b>	<b>Automjete të kontroll.</b>	<b>Lokale të kontroll.</b>	<b>Persona të arrestuar</b>	<b>Armë të konfiskuara</b>
Nëntor 2018	2.286	4.999	8.286	35.564	468	198	55
Dhjetor 2018	2.422	5.603	8.864	33.833	66	66	55
Janar 2019	2.794	7.329	9.033	35.354	127	127	68

3.2.8. IPK-ja është njohur me angazhimet policore në drejtim të ngritjes së sigurisë publike, por është interesuar t'i analizojë disa indikatorë për të vlerësuar se sa kanë qenë produktive dhe efikase angazhimet policore në ngritjen e sigurisë publike dhe me theks të veçantë, reduktimin e veprave penale të grabitjeve. Sipas statistikave të përgjithshme që burojnë nga raporte analitike të DRP-ve, numri i grabitjeve dhe grabitjeve me armë në vitin 2018, në nivel të vendit nuk është reduktuar me gjithë lëvizjet pozitive të disa DRP-ve. Me gjithë raportimet për ngritje të masave pro-aktive, nëse i vështrojmë indikatorët e përgjithshëm vjetor, në disa drejtori ka rënie të patrullimeve në këmbë, atyre me vetura dhe pikave të kontrollit. Është e nevojshme të analizohen këta indikatorë, ngase Urdhrat operativ kanë synuar ngritjen e masave pro-aktive. Një shqetësim tjetër që duhet trajtuar është edhe reduktimi i patrullimeve në këmbë që realisht është aktivitet i sektorëve patrullues, duke vënë në mëdyshje angazhimin e policëve patrullues në kuadër të sektorëve. Kjo mbështetet në faktin se me tërheqjen e policëve nga sektorët, mund të vie në pikëpyetje arritja e objektivave dhe zotimeve për policim cilësor siç e parasheh Strategjia për Policimin në Bashkësi. Përafrimi me komunitetin është e sigurt se sjellë rezultate pozitive drejt ofrimit të bashkëpunimit për një ambient më të sigurt. Bazuar në Raportin për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Policimin në Bashkësi, me gjithë aktivitetet me forumet e sigurisë, nuk vërehet se grabitjet kanë marrë fokusin



e nevojshëm. Qasja parandaluese duke ngritur bashkëpunimin me komunitetin duhet të trajtohet më seriozisht. Policia duhet të fokusohet më aktivisht në arritjen e synimeve të Strategjisë për Policim në Bashkësi, duke forcuar punën sektoriale dhe fuqizimin e bashkëpunimit me komunitet.

<b>Tabela nr. 3 - Produktiviteti i DRP-ve në parandalimin dhe hetimin e krimit (trendët e krimit në raport me masat pro-aktive të ndërmarra për vitin 2018)</b>					
<b>DRP</b>	<b>Trendet e krimit në raport me masat pro-aktive policore (+/-)</b>				
	<b>Vepra penale</b>	<b>Grabitje me armë</b>	<b>Patrullime në këmbë</b>	<b>Patrullime me veturë</b>	<b>Pika kontrolli</b>
Prishtinë	1.07	8	-13.9	14.25	-4.35
Gjakovë	-0.9	-40	-15.4	-1.5	-26
Mitrovicë Veriu	-14.5	-83	-20.5	-14.7	15.2
Mitrovicë Jugu	-6.4	-28	30.1	-2.9	4.8
Prizren	0.49	-27	-7	15	5
Pejë	5.0	50	-2.2	7.9	4.6
Gjilan	-7.5	50	-6.5	18.4	-0.1
Ferizaj	-6.3	-21	6	14.1	15

3.2.9. Policia duhet të bëjë përpjekje që kërkesave dhe thirrjeve të qytetarëve t’iu përgjigjet në kohë reale varësisht prioriteteve dhe angazhimeve policore. Sipas Udhëzuesit për zbatimin e monitorimin e programit të besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut, koha e reagimit llogaritet duke filluar nga pranimi i informatës nga Qendra Operative Rajonale Komunikuese (QORK), mbikëqyrësi apo Policia në ndonjërin nga format e komunikimit, koha e dhënies së informatës tek patrulla/njësi të ngarkohet, koha e nisjes së patrullës/njësitit të ngarkuar dhe arritja në vendngjarje. Koha mesatare e reagimit në vendin e ngjarjes për zonën urbane është llogaritur të jetë maksimumi 15 minuta, ndërsa për zonën rurale maksimum 30 minuta, varësisht nga lokacioni apo fshati ku ndodhë rasti, me përjashtime eventuale në disa zona të thella malore dhe në kushte të papërshtatshme atmosferike<sup>14</sup>. Procedura Standarde e Operimit-Koha e reagimit policor përcakton evidentimin e informatave lidhur me ngjarjet në logun ditor<sup>15</sup>. Sa i përket kohës së reagimit në situatat kur kanë ndodhur grabitjet me armë, IPK-ja gjeti se reagimi variron në bazë të lokacionit të vendit të ngjarjes apo periudhës kohore kur ka ndodhur ngjarja. IPK-ja jo në të gjitha rastet ka arritur që në bazë të radiologjeve të nxjerrë indikatorët e pranimit të informatave dhe reagimit policor.

<b>Tabela nr. 4 - Të dhëna mbi kohën e reagimit të njësive policore në rastet e grabitjeve me armë</b>					
<b>DRP</b>	<b>Raste të raportuara</b>	<b>Mostra (96%)</b>	<b>Koha e përgjithshme e reagimit (min)</b>	<b>Reagimi policor në zona urbane (min)</b>	<b>Reagimi policor në zona rurale (min)</b>
Prishtinë	126	126	9	8	12
Pejë	21	21	8	6	13
Prizren	8	7	13	13	13
Gjilan	12	12	9	8	11

<sup>14</sup> Departamenti për Operacione - Divizioni për Siguri Publike, *Procedura Standarde e Operimit - Koha e reagimit policor*, nr. referues DDO-04/085/2018, datë 07.09.2018.

<sup>15</sup> Logu ditor është pasqyrë e krijuar elektronike apo me shkrim, në të cilin duhet evidentuar informimet telefonike zyrtare të pranuar nga cilido informues të mundshëm për një rast apo ngjarje e caktuar të ndodhur më parë apo që është në zhvillim e sipër dhe po ashtu në log evidentohen edhe të gjitha informatat e pranuar në mënyra tjera të informimit për të cilat vlerësohen nëse janë të rëndësishme së veçantë.

Ferizaj	15	10	9	10	7
Gjakovë	3	3	15	-	15
Mitrovicë Jugu	13	12	5	3	6
Mitrovicë Veriu	1	0	-	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>199</b>	<b>191</b>	<b>10 min</b>	<b>8 min</b>	<b>11 min</b>

3.2.10. Bazuar në informatat e Sektorëve Rajonal të Hetimeve nga një mostër e gjërë prej 96% të të gjitha rasteve të grabitjeve me armë, koha e përgjithshme e reagimit policor në vendngjarje në kuadër të të gjitha DRP-ve pa marrë parasysh zonën e ndodhjes së rasteve, del të jetë rreth 10 minuta. Nëse nxjerrim kohën e reagimit policor vetëm për zonën urbane, është rreth 8 minuta, kurse në zonat rurale rreth 11 minuta. DRP - Mitrovicë Jugu ka pasur kohën më të shpejtë të reagimit policor në rastet e grabitjeve me armë, që është rreth 5 minuta (3 min. në qytet - 6 min. në zona rurale). IPK-ja nuk ka arritur të sigurojë të dhëna mbi kohën e reagimit nga njësitë policore të DRP - Mitrovicë Veriu me gjithë faktin se ka të raportuar një rast të vetëm gjatë vitit 2018. Në DRP - Gjakovë janë të raportuara grabitjet me armë të ndodhura në zona rurale, andaj nuk kemi indikatorin e kohës së reagimit për zonat urbane. IPK nuk ka arritur të sigurojë kohën e reagimit edhe për një numër rastesh të DRP-Ferizaj, meqë radiologjet kanë mungesë informacioni mbi kohën e reagimit, ose njësitë policore në ndërkohë janë vënë në ndjekje të grabitësve. Bazuar në këta parametra vlerësohet se koha e reagimit sipas zonave, del të jetë brenda standardeve. IPK vlerëson se reagimet policore kanë qenë të shpejta dhe në pajtim me kriteret e përcaktuara. Reagimi i njësisve në kuadër të këtyre parametrave të pranueshëm konsiderohet të jetë rezultat i mobilizimit të tyre në realizimin e planeve në luftimin e veprave penale të grabitjeve. IPK-ja inkurajon njësitë e stacioneve dhe DRP-ve që të angazhohen edhe më tej në shkurtimin e kohës së reagimit, nga koha kur merret informata deri te arritja në vendin e ngjarjes, në situatat kur kanë ngjarje të tilla.

3.2.11. Inspektorët kanë siguruar një mostër të gjërë të logjeve ditore për të vlerësuar ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme në përgjigje të rasteve të raportuara. Gjatë kontrollimit të logut të ngjarjeve ditore, shihet se jo në të gjitha rastet e raportimit të grabitjeve me armë, mund të sigurohen informatat mbi kohën e reagimit policor. Një numër i logjeve ditore kanë informacion jo të plotë (të mangët) mbi ngjarjet e ndodhura. Veç tjerash, janë vërejtur dallime në mes të DRP-ve edhe në mbajtjen e një logu standard të ngjarjeve ditore. Një numër i DRP-ve mbajnë një log më gjithëpërfshirës mbi ngjarjet ditore, krahasuar me disa DRP që përdorin format më të thjeshtë dhe me informata më të mangëta. Nevojitet që të punohet në drejtim të standardizimit të formës së raportimit-evidentimit të ngjarjeve ditore. Mospërfshirja e informatave të nevojshme në logun e ngjarjeve ditore cungon informacionin e nevojshëm të ngjarjeve - aktiviteteve. Kjo vlerësohet të ketë ardhur nga ngarkesa me informacione ditore, por edhe nga neglizhenca e njësisve policore në raportimin e informatave nga vendngjarja.

#### ***Rekomandimi nr. 2***

*IPK-ja u rekomandon Qendrave Operative Rajonale të Komunikimit që të aplikojnë së përdoruri formatin e logut ditor të ngjarjeve që ofrojnë një përfshirje më të gjërë informacioni mbi ngjarjet ditore, në drejtim që ato të sigurojnë një informacion më të plotë mbi aktivitetet policore lidhur me rastet e raportuara të veprave të dyshuara penale.*

3.2.12. Njësitë e rendit zakonisht arrijnë të parat në vendngjarje<sup>16</sup>. Vendit të ngjarjes zakonisht i përgjigjet patrulla e stacionit, njësitë e hetimeve të stacioneve policore, hetimet rajonale së bashku me njësitë e krim-teknikës. Veprimet policore që duhet të ndërmerren nga njësitë në menaxhimin e vendngjarjes janë të rregulluara me Procedurën Standarde të Operimit - Veprimet e përgjithshme policore në vendngjarje<sup>17</sup>, ku parashihet kryerja e detyrave dhe autorizimet në vendngjarje të çfarëdo incidenti apo rasti të raportuar dhe në të cilin vend është e nevojshme marrja e një sërë masash dhe veprimesh me qëllim të minimizimit të dëmeve, shpëtimit të jetëve, arrestimit dhe mbledhjes së dëshmimeve për kompletimin sa më të mirë të një rasti. Zakonisht vendngjarjes së grabitjeve dhe thujase në të gjitha rastet, i përgjigjen ekipet reaguese apo të sektorëve nga stacionet. Pas sigurimit të vendit të ngjarjes, ekipet e hetimeve rajonale dalin dhe merren me procedimin-ekzaminimin e vendngjarjes. Ruajtja dhe mbrojtja e vendngjarjes d.m.th ruajtja e vendit ku është kryer vepra penale si dhe vendi ku janë shfaqë pasojat në të njëjtat kushte fizike, ashtu si i ka lënë kryesi i veprës penale. Mbrojtja e vendngjarjes fillon me policin e parë në vendngjarje dhe duhet t'i përmbahet tërësisë dhe qëllimeve të kufizuara vijuese, përfshirë këtu kontrollimin e gjendjes së viktimave - të lënduarëve, ofrimin e ndihmës, tentimin për të siguruar informata rreth të dyshuarve dhe largimit të tyre prej vendngjarjes për të orientuar ndjekjen, kapjen e kryesve dhe sigurinë e tyre, si dhe mbrojtjen e vendit të ngjarjes.

3.2.13. Procedura Standarde e Operimit përcakton detyrat primare<sup>18</sup> dhe sekondare<sup>19</sup> të policit të parë në vendngjarje. Të gjitha veprimet në vendngjarje që rrjedhin nga detyrat primare dhe sekondare të policit të parë në vendngjarje duhet të përcillen më vonë në raportin e policit të parë. Inspektorët në Sektorët e Hetimeve Rajonale kanë kontrolluar 19 dosje të rasteve të grabitjeve të proceduara me kallëzim penal në Prokurori. Në dosjet e tilla ekzistojnë raportet e policit të parë në vendngjarje, por në to përveç që shkruhet për marrjen e informatës dhe shkuarjen në vendngjarje, nuk përshkruhen veprimet primare dhe sekondare të ndërmarra deri në ardhjen e njërive hetimore dhe krim-teknikës. IPK nga këto raporte nuk ka mundur të vlerësojë nëse polici i parë në vendin e ngjarjes ka ndërmarrë hapat dhe veprimet që kërkohen dhe parashihen me PSO. Mospasqyrimi i veprimeve të ndërmarra, nga IPK-ja konsiderohet lëshim nga mbikëqyrësi i policit të parë në vendin e ngjarjes dhe vet polici. Mosmarrja dhe mosparaqitja e veprimeve në raport mund të dëmtojë seriozisht rastin dhe kjo ndikon në efikasitetin për luftimin e grabitjeve si dukuri shqetësuese.

---

<sup>16</sup> PSO e trajton vendin e ngjarjes si vend apo lokacion ku ka ndodhur një krim, i cili mund të jetë në ambient të hapur ose të mbyllur. Sipas PSO-së, ambient i hapur mund të jetë çdo hapësirë në natyrë, ndërsa ambient i mbyllur mund të jetë: shtëpi, banesë, lokal, podrum, tavan, duke përfshirë edhe automjetet.

<sup>17</sup> Departamenti i Operacioneve, *Procedura Standarde e Operimit - Veprimet e përgjithshme policore në vendngjarje*, nr. referues DDO-04/030/2013, datë 28.02.2013.

<sup>18</sup> Detyrat primarepërfshijnë: identifikimin dhe eventualisht ndalimin e personit, i cili i pari ka njoftuar Policinë për rastin, përcaktimin e kryesit të veprës penale duke bërë hetimin direkt ose vëzhgimin nëse identiteti i tij nuk është i njohur, ndalimin e dëshmitarëve të mundshëm dhe ndarjen e tyre ashtu që deklarata e tyre të pavarura mund të sigurohen më vonë, parandalimin e hyrjes së personave të paautorizuar dhe të parëndësishëm në vendin e ngjarjes ose që pengojnë në ndonjë mënyrë procesin, sigurimin e vendit të ngjarjes duke përdorur pengesa të ndryshme, të jetë syhapur që asgjë nga vendi i ngjarjes të mos anashkalohej apo të konsiderohet e parëndësishme, mbajtjen e evidencës mbi personat që hyn në vendngjarje dhe largimin e tyre.

<sup>19</sup> Detyrat sekondare përfshijnë: regjistrimin e veprimeve sekondare (datën, kohën) që duhet të përcillen më vonë në raportin e policit, të siguroj ose marrë dëshmitë nëse ato mund të ndryshohen ose prishen si rezultat i kushteve atmosferike, të fotografij vendngjarjen nëse ka mundësi deri në ardhjen e hetuesit dhe krim-teknikut, sigurimin e dëshmitarëve pasi ata mund të largohen, t'i kushtohet vëmendje automjeteve të parkuara në dhe jashtë vendit të ngjarjes para largimit të tyre nga vendngjarja ngase mund të prishin apo zhdukin provat, sigurimin se askush mos t'i marr apo largoj objektet dhe gjësendet që mund të konsiderohen si dëshmi apo prova me vlerë.

### **Rekomandimi nr. 3**

*IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore dhe mbikëqyrësve të policëve të parë në vendngjarje që të ushtrojnë mbikëqyrje efikase mbi vartësit e tyre lidhur me ndërmarrjen dhe raportimin e veprimeve të nevojshme në vendngjarje, konform Procedurës Standarde të Operimit - Veprimet e përgjithshme policore në vendngjarje, në mënyrë që veprimet e tilla të kontribuojnë në procesin e hetimit dhe zbulimit të kryesve të veprave penale.*

3.2.14. Në kuadër të DRP-ve si pjesë e strukturës së hetimeve rajonale veprojnë Njësitë Rajonale të Teknikës Kriminalistike (NJRTK) dhe Njësitë Rajonale të Hetimeve (NJHR), si njësi të ndara. Kompetencë e NJRTK-së është ushtrimi i veprimtarisë në territorin e regjionit përkatës dhe merren me rastet që i hetojnë NJRH-të, njësitë e hetimeve të **Departamentit** të Krimeve të Rënda dhe Kundër Krimin të Organizuar, me çka kuptohet se kemi të bëjmë me kompetenca territoriale dhe kompetenca lëndore. NJRTK-të kanë burime të specializuara për sigurim dhe trajtim të dëshmimeve nga vendi i ngjarjes dhe zakonisht këta punonjës ftohen në vendngjarje kur kemi vepra penale që bien në domenin e tyre. Një ndër detyrat dhe përgjegjësitë e teknikut që del në vendngjarje është që të skicojë vendin e ngjarjes dhe dokumentojë lokacionin e dëshmimeve, siç parashihet në kapitullin VIII të Procedurës Standarde të Operimit<sup>20</sup>, paragrafi 8.4, pika j. Gjatë kontrollit dhe analizimit të dosjeve të ekzaminuara që bien në domenin e NJRTK-së, skicimi i vendit të ngjarjes nuk është zbatuar në pesë (5) raste<sup>21</sup>. Fotografimi i vendngjarjes ka një rëndësi të veçantë dhe shërben për të dëshmuar se çka është gjetur aty. PSO në kapitullin XII, pika D (Fotografimi i vendit të ngjarjes) në paragrafin 1 potencon që fotografitë e vendit të ngjarjes paraqesin një regjistër të përhershëm të vendit të ngjarjes dhe shërbejnë si plotësim i raporteve dhe skicave të vendit të ngjarjes. Ato shërbejnë si dëshmi për të mbështetur dëshmimin e policit (teknikut kriminalist) se çka ka gjetur në vendin e ngjarjes dhe dëshmimin e hetuesit se çka ka parë në vendin e ngjarjes, po ashtu edhe lokacionin, llojin dhe gjendjen faktike të vendit të ngjarjes. Nga 19 rastet e kontrolluara, ky kriter nuk është zbatuar në dy (2) raste<sup>22</sup>. Lëshimet e tilla mund të paraqesin pengesë gjatë procedurës penale dhe rezultojnë nga neglizhenca dhe kujdesi jo i duhur i zyrtarëve kompetent në vendngjarje.

3.2.15. Për t'u konsideruar e kompletuar, lënda duhet të përmbajë shkresa që pasqyrojnë veprimet që janë ndërmarrë nga zyrtarët kompetent. Procedura Standarde e Operimit në kapitullin XXXIX (Përmbajtja e dosjes së Teknikës Kriminalistike), në pikën 39.3 parashihet që dosja e rastit duhet të jetë e saktë, e organizuar dhe duhet të përmbajë të gjitha informatat dhe dokumentet e nevojshme<sup>23</sup>.

<sup>20</sup> Shtylla e Hetimeve të DPP- Prishtinë, *Procedurat Standarde të Operimit të Teknikës Kriminalistike - Sektori i vendit të ngjarjes*, nr. referues PK/SHH-PSO 1.21, datë 12.04.2012.

<sup>21</sup> DRP- Prizren (2018-GB-298), DRP- Gjilan (2018-CA-009), DRP-Ferizaj (2018-CF-915, 2018-CF-1623, 2018-CP-2271).

<sup>22</sup> DRP- Gjakovë (2018-EA-088 dhe 2018-EA-089).

<sup>23</sup> Dosja e rastit duhet të përmbajë: raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, formën e listës së dëshmimeve dhe zinxhirin e ruajtjes së dëshmimeve me të gjitha nënshkrimet duke filluar nga polici që ka marrë dëshminë në vendngjarje dhe rrugëtimin e dëshmimeve për procesim dhe çdo lëvizje tjetër e dëshmimeve, skicën e përgjithshme (kroki), skicën e detajuar, gjitha shënimet origjinale nga vendngjarja, fotoalbumin dhe përshkrimin e fotografive, raportin e autopsisë (nëse kemi të bëjmë me trup të vdekur) dhe fotoalbumin me përshkrim, shenjat e gishtave - post mortum (autopsi), raportin e ekzaminimit të veturës (nëse kemi të bëjmë me ndonjë veturë) dhe fotoalbumin me përshkrim, raportin e bastisjes në rast të pjesëmarrjes së teknikes kriminalistike në bastisje ku duhet të dokumentohen të gjitha veprimet e ndërmarrura nga teknika kriminalistike (ky raport nuk e zëvendëson procesverbalin mbi bastisjen, i cili bëhet nga hetuesi apo prokurori), si dhe të gjitha dokumentet/shkresat/raportet, skicat dhe fotografitë tjera relevante me rastin.

Në 12 nga 19 dosje të kontrolluara, skica e përgjithshme (kroki) dhe skica e detajizuar, në kohën e inspektimit nuk kanë qenë pjesë e tyre<sup>24</sup>. Mungesa e këtyre skicave vlerësohet të jetë rezultat i neglizhencës e moskujdesit të duhur të personelit të njërive kompetente hetimore. Mosndërmarrja e të gjitha veprimeve të nevojshme mund të ketë efekte negative në kryerjen e duhur të detyrave policore dhe kompletimit të dosjeve hetimore, që mund të ndikojë në arritjen e rezultateve pozitive për zbulimin e veprave penale dhe kapjen e kryesve të tyre.

3.2.16. Policia heton veprat penale dhe të njëjtat ia raporton Prokurorit në kohën sa më të shpejtë të mundur. Gjatë hetimit të veprave penale, ajo i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për zbulimin e kryesve të veprave penale. Bazuar në Procedurën Standarde të Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit (ZDPO/02/021/2013), paragrafi 5.6 (Procedimi i lëndëve - rasteve) parasheh që hetuesi, i cili është i ngarkuar me hetimin e rastit, fillimisht lidhur me rastin duhet ta plotësoj formën standarde për informim të Prokurorit, ta dërgoj te Prokurori, pastaj në bashkëpunim të ngushtë me rreshterin/togerin e njësisë duhet të bëjë një plan veprimi sipas të cilit do të zhvillohet procesi i hetimit të rastit. Inspektimi vë në pah se në të gjitha rastet e kontrolluara, Prokurori kompetent ishte njoftuar për rastet që kishin ndodhur. Sa i përket planit të veprimit sipas të cilit do të zhvillohet procesi i hetimit për rastin, ky plan nuk ka ekzistuar në 13 nga gjithsej 19 rastet e inspektuara të grabitjeve me armë<sup>25</sup>. Mungesa e planeve të veprimit në rastet e trajtuara vlerësohet të jetë rezultat i neglizhencës së personelit dhe menaxhmentit të njërive kompetente hetimore për hetimin e rasteve. Mosnxjerrja e planeve të veprimit mund të ketë efekte negative në kryerjen e mirë të detyrave dhe arritjes së rezultateve pozitive drejt zbulimit të veprave penale dhe kapjes së kryesve të tyre.

#### **Rekomandimi nr. 4**

*IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të njërive të krim-teknikës dhe hetuesve të këtyre njërive përgjegjëse për menaxhimin dhe trajtimin e vendit të ngjarjes që të ushtrojnë mbikëqyrje më efektive dhe kujdes të shtuar gjatë kryerjes së detyrave në vendin e ngjarjes, në drejtim të kompletimit të dosjeve të vendit të ngjarjes në pajtim me rregullat dhe procedurat në fuqi.*

3.2.17. Njësitë hetimore që merren me hetimin e këtyre rasteve të grabitjeve vazhdimisht janë në bashkëpunim dhe koordinim me Prokurorin e Shtetit dhe komunikimi i ndërsjellë është i rregullt nga momenti i paraqitjes së rastit, si dhe në koordinim me të, ndërmerren gjitha veprimet hetimore bazuar në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, Ligjin e Policisë, Udhëzimet Administrative dhe PSO-të në fuqi. Neni 71 i Kodit (Mbledhja e provave nga vendi i ngjarjes) përcakton se "Policia me kujdes mbledhë provat që gjenden në vendin e ngjarjes për veprën e dyshuar penale dhe i ruan ato në mënyrë të përshtatshme që lejon provat të testohen nga laboratorit kompetent". Kur bëhet kompletimi i hetimit, hetuesi duhet të dërgojë lëndën për kontrollë dhe nënshkrim te shefi i njësisë së hetimeve (rreshteri, togeri, kapiteni) dhe nuk lejohet që të dërgohet në Prokurori pa nënshkrimin e shefit të njësisë apo në mungesë të tij, të zëvendësit të tij, siç parashihet në Procedurën Standarde

<sup>24</sup> DRP- Prishtinë (2018-AF-0862), DRP- Mitrovicë Jugu (2018-BI-136), DRP- Mitrovicë Veriu (2018-SI-043), DRP- Gjakovë (2018-EA-088, 2018-EB-424 dhe 2018-EA-089), DRP- Prizren (2018-GB-298), DRP- Gjilan (2018-CA-009 dhe 2018-CB-039) dhe DRP- Ferizaj (2018-CF-915, 2018-CF-1623, 2018-CP-2271).

<sup>25</sup> DRP- Prishtinë (2018-AF-0862), DRP- Mitrovicë Jugu (2018-BI-136, 2018-BI-110), DRP- Mitrovicë Veriu (2018-SI-043, 2018-BI-148), DRP- Pejë (2018-DC-122, 2018-DF-339, 2018-DA-1670), DRP- Gjilan (2018-CA-009 dhe 2018-CB-039) dhe DRP- Ferizaj (2018-CF-915, 2018-CF-1623, 2018-CP-2271).

të Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit, në paragrafin 5.7 (Procedimi i lëndëve - rasteve). Nga 19 rastet që kanë qenë subjekt i inspektimit, vetëm në një rast, lënda është dërguar në Prokurori pa u nënshkruar nga shefi i njësisë së hetimeve<sup>26</sup>. Mungesa e nënshkrimit të këtij rasti vlerësohet se është rezultat i neglizhencës dhe moskujdesit adekuat të hetuesit të rastit dhe menaxhmentit të njësisë së hetuesisë. Moskujdesi nga personeli kompetent mund të ketë efekt negativ lidhur me ushtrimin e mbikëqyrjes adekuate nga menaxhmenti i njësive gjatë hetimit dhe administrimit të rasteve penale. IPK inkurajon mbikëqyrësit e njësive të hetimeve në sektorët rajonal të hetimeve që të ushtrjnë mbikëqyrje adekuate gjatë hetimit dhe administrimit të rasteve në pajtim me rregullat dhe procedurat.

3.2.18. Bazuar në intervistat e realizuara dhe të dhënat e siguruara, rastet e grabitjeve me armë, janë trajtuar me prioritet të veçantë nga menaxhmenti, duke iu dhënë mundësi njësive dhe stacioneve të shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore dhe logjistike nga DRP-të. Këto Drejtori kanë caktuar zyrtarë policor si mbikëqyrës dhe koordinator në implementimin e planeve operative dhe bashkërendimin e të gjitha veprimeve policore si në parandalim, ashtu edhe në hetim. Në drejtim të ngritjes së masave të sigurisë në realizimin e urdhrave dhe planeve operative, nga DPP-ja është kërkuar të angazhohen nga dy epror në nivel rajonal për të inspektuar njësitë policore në kryerjen e detyrave të përcaktuara, në patrulla sektoriale, sigurim të objekteve dhe në zona të ndjeshme. Dhënia prioritet për trajtim të grabitjeve pasqyrohet me planet operative, urdhrat operativ dhe planet vepruese, ku në të gjitha është cekur parandalimi i veprave penale e në fokus të grabitjeve, edhe arrestimi i personave të përfshirë. Se Policia është e përkushtuar në dhënien prioritet të këtyre rasteve vlen të përmendet edhe takimi i datës 07.09.2018, i Shefave të Sektorëve të Hetimeve Rajonale, Shefave të Hetimeve të Përgjithshme në nivel rajonal dhe Shefave të Sektorit të grabitjeve në nivel rajonal me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, ku është biseduar për koordinim dhe bashkëpunim të të gjitha njësive rajonale në hetimin e grabitjeve. IPK çmon veprimet menaxheriale në prioritetizimin e rasteve të grabitjeve dhe inkurajon menaxherët që edhe më tutje të përkushtohen dhe mobilizohen drejt ngritjes së sigurisë publike dhe parandalimit të aktiviteteve kriminale që shqetësojnë qytetarët.

3.2.19. Meqë informacionet e siguruara gjatë fazës së parë të inspektimit nuk kanë qenë kurajuese, IPK-ja është mobilizuar në sigurimin e informacioneve më të freskëta për të vlerësuar indikatorët e suksesit të performancës së njësive hetimore në hetimin dhe zbulimin e kryesve të veprave penale. Informatat shtesë janë kërkuar edhe me qëllim të identifikimit të numrit të saktë të grabitjeve me armë. Në fazën e dytë të sigurimit të të dhënave, Sektorët Rajonal të Hetimeve kanë ofruar të dhëna të azhuruara, me çka edhe është qartësuar numri i grabitjeve të raportuara, të cilat janë kryer me armë. Informacionet e fundit kanë dhënë edhe pasqyrën e performancës policore në hetimin dhe zbulimin e kryesve të grabitjeve me armë dhe informatat e tilla janë pasqyruar në tabelë. Nga tabela pasqyrohet se 79 raste apo 40% e grabitjeve me armë të raportuara gjatë vitit 2018 janë proceduar në Prokurori me kallëzime penale të ngritura me kryes të njohur. Janë 46 raste apo 23% e grabitjeve me armë, të cilat janë proceduar në Prokurori me kallëzime të ngritura me kryes të panjohur, kurse nën hetime vazhdojnë të mbesin 75 raste tjera apo 37% e rasteve të raportuara gjatë vitit 2018.

3.2.20. Sektori Rajonal i Hetimeve në DRP- Prishtinë ka qenë i ngarkuar tej mase me raste penale të kësaj natyre. Me gjithë numrin e konsiderueshëm të rasteve të zbuluara, mbetet ende i lartë numri

<sup>26</sup> DRP- Mitrovicë Veriu (rasti 2018-SI-043).

i rasteve të proceduara në Prokurori me kryes të panjohur dhe rasteve nën hetim. Në përjashtim të DRP- Gjakovë dhe DRP - Mitrovicë Veriu që nuk kanë raste të hapura, të gjitha DRP-të ballafaqohen me numër të madh të rasteve nën hetim. DRP- Mitrovicë Jugu, DRP- Ferizaj, DRP- Gjilan dhe DRP- Prizren kanë shkallë më të ulët të efikasitetit në zbulimin e kryesve të veprave penale të grabitjeve me armë. DRP- Prizren nuk ka asnjë rast të zbuluar, të proceduar me kallëzim penal në Prokurori kompetente. Në takimet me zyrtarë policor, IPK-ja është informuar se këto vepra janë duke u kryer nga grupe të organizuara mirë, të maskuar dhe duke mos lënë gjurmë në vendngjarje. IPK-ja çmon punën e bërë në hetimin e veprave penale të grabitjeve me armë, por vlerëson se duhet punuar më fuqishëm në ngritjen e sigurisë publike, ngase kjo dukuri po paraqitet shqetësuese për komunitetin dhe bizneset.

<b>Tabela nr. 5 - Të dhëna statistikore mbi efikasitetin e njësive hetimore në hetimin dhe zbulimin e kryesve të veprave penale të grabitjeve me armë të raportuara në vitin 2018 (datë 05.04.2019<sup>27</sup>)</b>							
<b>DRP</b>	<b>Numri i rasteve</b>	<b>Kallëzime penale me kryes të njohur</b>	<b>%</b>	<b>Kallëzime penale me NN</b>	<b>%</b>	<b>Raste nën hetim të njësive</b>	<b>%</b>
Prishtinë	126	55	43	34	28	37	29
Pejë	21	13	62	8	38	0	0
Ferizaj	15	4	27	0	0	11	73
Mitrovicë Jugu	13	1	8	0	0	12	92
Gjilan	12	2	17	2	17	8	66
Prizren	8	0	0	1	13	7	87
Gjakovë	3	3	100	0	0	0	0
Mitrovicë Veriu	1	1	100	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>199</b>	<b>79</b>	<b>40%</b>	<b>45</b>	<b>23%</b>	<b>75</b>	<b>37%</b>

#### **Rekomandimi nr. 5**

*IPK-ja u rekomandon Udhëheqësve të Sektorëve Rajonal të Hetimeve në kuadër të Drejtorive Rajonale Policore të Mitrovicës Jugu, Prizrenit, Ferizajt dhe Gjilanit, që në vazhden e trajtimit të veprave penale të grabitjeve me armë, të mobilizohen më fuqishëm në hetimin dhe zbulimin e kryesve të tyre, duke ngritur efikasitetin në trajtimin e rasteve të hapura, si dhe duke i kontribuar ngritjes së sigurisë publike dhe imazhit policor.*

3.2.21. Meqenëse sektori bankar është prekur me të madhe nga individ dhe grupe kriminale, janë realizuar takimet shumëpalëshe me Policinë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Bankën Qendrore të Kosovës, Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe përfaqësuesit e kompanive private të sigurimit. Me qëllim të parandalimit të grabitjeve, është krijuar një grup punues, të cilin e përbëjnë përfaqësues të këtyre mekanizmave, që synon ngritjen e bashkëpunimit, identifikimin e masave preventive që duhet ndërmarrë nga institucionet bankare, bizneset, etj. Në periudhën kur është realizuar ky inspektim, ka qenë aktuale arritja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të këtyre mekanizmave. IPK-ja çmon bashkëpunimin policor me akterët e tillë, duke vlerësuar se i kontribuon angazhimeve në luftimin e kimit dhe krijimit të një ambienti më të sigurtë.

<sup>27</sup> Të dhënat e azhurnuara janë siguruar nga Sektorët Rajonal të Hetimeve deri me datën 05.04.2019.

### 3.3. Kapacitetet e burimeve njerëzore dhe teknike

3.3.1. Sa i përket kapaciteteve njerëzore, IPK-ja ka gjetur se në përgjithësi DRP-të në vazhdimësi ballafaqohen me disponueshmëri të pamjaftueshme të personelit, që vërehet nga mosharmonizimi i kapaciteteve me Listën e Personelit të Autorizuar (LPA). Gjendjen e vështirëson edhe angazhimi i një numri të madh të policëve në Drejtorinë për Sigurim të Objekteve me Rëndësi të Veçantë dhe Personalitete, Fakultetin e Shkencave të Sigurisë - Vushtri, në aktivitete të ndryshme jopolicore, etj. Përkundër vështirësive me personel, DRP-të nuk kanë neglizhuar rastet e sidomos të atyre të grabitjeve, të cilat janë trajtuar me seriozitet të lartë, duke shpërndarë burimet njerëzore konform nevojave të paraqitura në terren, në stacionet policore në të cilat ka pasur mungesa të personelit kanë dërguar personel të NJRSH dhe NJSO, të cilët kanë bërë pika kontrolli në zona të stacioneve policore dhe i kanë përkrahë ato. IPK-ja pas analizimit të orareve të punës vlerëson se numri i zyrtarëve policor në kuadër të DRP-ve, gjegjësisht stacioneve, në ditët kritike kur kanë ndodhur rastet e grabitjeve me armë ka qenë i mjaftueshëm në përgjigje të rasteve të raportuara. IPK-ja edhe njëherë e vlerëson të nevojshme ndërmarjen e veprimeve në drejtim të harmonizimit të kapaciteteve aktive të burimeve njerëzore me LPA-në, me qëllim të ngritjes së performances dhe sigurisë publike.

3.3.2. Sa i përket kapaciteteve teknike, DRP-të kanë numër të pamjaftueshëm të automjeteve në dispozicion, përfshirë edhe ato "të mbuluar". Vërehet mungesë e kompjuterëve, llap topëve, pajisjeve teknike për bartjen e shënimeve nga terreni të videomaterialeve të siguruar nga kamerat e vëzhgimit, pajisjeve për komunikim, aparateve për fotografim të vendngjarjes. Gjatë intervistave në DRP, IPK gjeti si nevojë të domosdoshme edhe pajisjen e stacioneve policore me armë të gjata, duke arsyetuar se njësitë patrulluese të stacioneve janë të parat që ballafaqohen në vendngjarje, apo në ndjekjen e grabitësve, të cilët në disa raste kanë rezistuar ndaj urdhrave dhe reagimit policor, duke përdorur armët e gjata e pistoletat. Këto situata e vënë zyrtarin policor në disavantazh me grabitësit, rrezikojnë jetën e zyrtarëve policor dhe të qytetarëve. Inspektimi nxorri në pah se në kuadër të aktivitetit për parandalimin dhe zbulimin e veprave penale të grabitjeve, DRP-të mbështeten nga DPP-ja me kapacitete njerëzore (operator nga NJSO) dhe teknike (vetura civile). Përkundër të gjitha këtyre vështirësive me kapacitete teknike në DRP, nuk kanë neglizhuar rastet madhore e sidomos të grabitjeve, të cilat janë trajtuar me seriozitet, duke shpërndarë burimet teknike konform nevojave në terren. IPK vlerëson se mungesat e pajisjeve paraqesin vështirësi në kryerjen e duhur të detyrave.

#### **Rekomandimi nr. 6**

*IPK-ja i rekomandon Departamentit për Shërbime Mbështetëse që në bashkëpunim me njësitë policore të DRP-ve dhe stacioneve policore të angazhuara në parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave penale, të identifikojnë nevojat e tyre, në drejtim të ofrimit të kushteve optimale teknike për punë më efikase, duke u fokusuar në sigurimin e mjeteve të domosdoshme, si: automjetet, pajisjet teknike dhe armët e gjata.*

3.3.3. Në takimet e realizuara me udhëheqës të Sektorëve të Hetimeve Rajonale, janë paraqitur ide dhe propozime që në drejtim të parandalimit dhe luftimit të këtyre veprave, të ndërmerren nisma në bashkëpunim me komunat drejt financimit të projekteve teknike të vendosjes së kamerave në vende publike, të cilat do të ofronin mundësi për një qasje më serioze operative drejt zbulimit të grabitësve. Këto propozime kanë rrjedhur si ide nga vet njësitë hetimore, ngase vlerësohet se largimi i grabitësve nga vendngjarja shumë herë bëhet edhe përmes rrugëve që nuk mbulohen me video monitorim. IPK



çmon nismat që në bashkëpunim me komunitetin në zbatim të Strategjisë për Policim në Bashkësi, shumë zona kanë arritur të realizojnë projekte për mbulimin e zonave me video monitorim në vende publike. Nismat e tilla duhet të jenë edhe më evidente. IPK mbështet nismat e tilla dhe vlerëson të domosdoshme vendosjen e kamerave në rrugët hyrëse dhe dalje, të cilat mund të jenë rrugë ku grabitësit i shfrytëzojnë për qëllimet e tyre kriminale. Një sistem i tillë i monitorimit është evident në komunën e Ferizajt, ku monitorimi i pamjeve nga rrugët kryesore të qytetit menaxhohet nga DRP.

3.3.4. IPK-ja ka vizituar Divizionin e Trajnimeve për t'u njohur me trajnimet e zyrtarëve policor në luftën kundër krimeve, me theks të veçantë grabitjeve me armë. IPK është njohur se Divizioni i Trajnimeve që nga trajnimi themelor për polic e në vazhdimësi, trajnon stafin policor lidhur me sigurinë e policit në situata të ndryshme. Gjatë kontrollimit të dosjeve të programeve trajnuese në Drejtorinë për Mbështetje të Trajnimeve lidhur me Trajnimin themelor për polic të ri, shihet se zhvillohen edhe temat që kanë të bëjnë me situatat kur zyrtarët policor ballafaqohen me veprat penale të grabitjes. IPK-ja gjeti se në dosje trajtohen edhe temat, si: siguria e policit, përdorimi i forcës, aftësitë e policit për të mbijetuar, kontrollimi me turma, menaxhimi i sigurisë publike, reagimi ndaj incidenteve të rënda, mbështetja policore për organizata, institucionet jashtë policore, reagimi ndaj alarmit në banka, menaxhimi i incidentit nga policët e patrullës, menaxhimi i vendit të ngjarjes, veprimet në vendngjarje, ndalimi i veturave, arrestimi i personave me rrezikshmëri të lartë, përdorimi i armëve të zjarrit nga zyrtarët policor, veprimi në vendin e krimit, njohja me provat materiale, teknikat kriminalistike - gjurmët e gishtave, mikro - gjurmët, këqyrja e vendit të ngjarjes, ri-certifikimi për përdorim të armës së zjarrit, ndërhyrja dhe sjellja në konflikt në rrethana të ndryshme, vetëdijesimi mbi vetësigurinë, taktikat mbrojtëse dhe menaxhimi i incidentit kritik. Trajnimi për Njësitë e Specializuara trajton temat, si: vjedhja grabitqare dhe grabitja, menaxhimi i vendngjarjes, arrestimi dhe paraburgimi, hetimet mbi grabitjet dhe vjedhjet grabitqare, disa vepra penale kundër jetës dhe trupit. Divizioni i Trajnimeve në bashkëpunim me të gjitha DRP-të, çdo vit mban trajnime të brendshme, në kuadër të të cilave trajtohen edhe temat e lartcekura. IPK çmon plan-programet për mënyrën e trajtimit - reagimit për raste kur kërkohet intervenim dhe inkurajon Divizionin e Trajnimeve (Njësinë për Zhvillim të Planeve Mësimore) të planifikojë dhe të realizojë trajnime të avansuara bazuar në zhvillimet teknologjike mbi identifikimin - trajtimin e grabitjeve.

3.3.5. Për arsye të rritjes së numrit të këtyre veprave penale, me rekomandim të Departamentit për Operacione, Divizioni i Trajnimeve ka filluar trajnimin për përdorimin e armëve AK-47 dhe MP-5 për zyrtarë të DRP- Prishtinë me disa stacione policore, DRP - Pejë me disa stacione policore si dhe zyrtarë të Stacionit Policor të Gjakovës. Po ashtu, nga mesi i janarit të këtij viti ka filluar implementimi i programit të trajnimit për polic të ri, në të cilin janë të përfshira shumë module mësimore, ku kadetët do të mësojnë përveç përdorimit të armës Glock, edhe si përdoren armët e gjata AK-47 dhe MP-5. Gjithashtu, do të mësojnë si të vetëmbrohen në rast të intervenimit me armë apo kërcënimin, reagimin ndaj alarmit në banka, etj. IPK-ja vlerëson këto nisma në Polici që synojnë ngritjen e sigurisë për zyrtarët policor në parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit, por edhe të sigurisë së përgjithshme.

## 4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

### 4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 06.05.2019, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	IPK-ja u rekomandon zyrtarëve policor dhe njësisve policore të stacioneve dhe drejtorive rajonale, që në drejtim të sigurimit të informatave rreth kërcënimeve për sigurinë publike, të thellojnë bashkëpunimin dhe partneritetin me qytetarët, bizneset, shoqatat, forumet e sigurisë, në mënyrë që kontributi i tyre të jetë i mundshëm për krijimin e një ambienti të qetë dhe më të sigurt.	-I-	Pajtohem me këtë rekomandim dhe DRP-të udhëzohen që të shtojnë bashkëpunimin me partnerë relevant në këtë fushë.	Qershor 2019
2.	IPK-ja u rekomandon Qendrave Operative Rajonale të Komunikimit që të aplikojnë së përdoruri formatin e logut ditor të ngjarjeve që ofrojnë një përfshirje më të gjërë informacioni mbi ngjarjet ditore, në drejtim që ato të sigurojnë një informacion më të plotë mbi aktivitetet policore lidhur me rastet e raportuara të veprave të dyshuara penale.	-I-	Edhe në disa DRP ky log mbahet rregullisht do të marrim masa urgjente që kjo të zbatohet në çdo Qendër Operative.	Qershor 2019
3.	IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore dhe mbikëqyrësve të policëve të parë në vendngjarje që të ushtrojnë mbikëqyrje efikase mbi vartësit e tyre lidhur me ndërmarrjen dhe raportimin e veprimeve të nevojshme në vendngjarje konform Procedurës Standarde të Operimit - Veprimet e përgjithshme policore në vendngjarje, në mënyrë që veprimet e tilla të kontribuojnë në procesin e hetimit dhe zbulimit të kryesve të veprave penale.	-I-	Do të përcillen PSO-të dhe do të shtohet kontrolli i raporteve nga mbikëqyrësit.	Qershor 2019
4.	IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të njësisve të krim-technikës dhe hetuesve të këtyre njësisve përgjegjëse për menaxhimin dhe trajtimin e vendit të ngjarjes që të ushtrojnë mbikëqyrje më efikase dhe kujdes të shtuar gjatë kryerjes së detyrave në vendin e ngjarjes, në drejtim të kompletimit të dosjeve të vendit të ngjarjes në pajtim me rregullat dhe procedurat në fuqi.	-I-		Qershor 2019

5.	<i>IPK-ja u rekomandon Udhëheqësve të Sektorëve Rajonal të Hetimeve në kuadër të Drejtorive Rajonale Policore të Mitrovicës Jugu, Prizrenit, Ferizajt dhe Gjilanit, që në vazhden e trajtimit të veprave penale të grabitjeve me armë, të mobilizohen më fuqishëm në hetimin dhe zbulimin e kryesve të tyre, duke ngritur efikasitetin në trajtimin e rasteve të hapura, si dhe duke i kontribuar ngritjes së sigurisë publike dhe imazhit policor.</i>	<i>-II-</i>	<i>Do të intensifikohet, krahasohet efikasiteti i hetuesve rajonale.</i>	<i>Dhjetor 2019</i>
6.	<i>IPK-ja i rekomandon Departamentit për Shërbime Mbështetëse që në bashkëpunim me njësitë policore të DRP-ve dhe stacioneve policore të angazhuara në parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave penale, të identifikojnë nevojat e tyre, në drejtim të ofrimit të kushteve optimale teknike për punë më efikase, duke u fokusuar në sigurimin e mjeteve të domosdoshme, si: automjetet, pajisjet teknike dhe armët e gjata.</i>	<i>-III-</i>	<i>Do të ngriten kërkesa për pajisje logjistike dhe mjete tjera të nevojshme për SHR-të në veçanti për vetura me targa civile dhe pajisje tjera specifike.</i>	<i>Qershor 2020</i>